

Ftesë për pjesëmarrje në Konferencën Shkencore: “Shqiptarët në sytë e të huajve: Rrëfime, perceptim dhe realitete (shek. XIX-XX)”.

I/e nderuar,

Kemi kënaqësinë t’ju ftojmë të merrni pjesë në Konferencën Shkencore: **“Shqiptarët në sytë e të huajve: Rrëfime, perceptim dhe realitete (shek. XIX-XX)”**, e cila organizohet nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë-Institutin e Historisë-Tiranë. Konferenca do të mbahet më 28 shtator 2026.

Tezat e konferencës:

Rrëfimet e udhëtarëve dhe misionarëve të huaj mbi shqiptarët

- Ditarë udhëtimi, kujtime, letra, vëzhgime nga terreni.
- Subjektiviteti i autorëve.
- Gjeografia dhe trashëgimia natyrore e trojeve shqiptare në sytë e të huajve.

Shqiptarët në diskursin orientalizues dhe romantik

- Ndërtimi i figurës së “tjetrit ballkanik” në narrativën perëndimore.
- Ndikimi i rrymave intelektuale europiane në përfytyrimin e shqiptarëve.
- Imazhi i shqiptarëve në artet figurative të autorët e huaj.

Perceptime mbi organizimin shoqëror, familjen, ekonominë dhe jetën e përditshme shqiptare

- Familja, gjinia, marrëdhëniet ekonomike, shoqërore dhe kultura materiale.
- Jeta e përditshme e shqiptarëve.
- Krahasime rajonale në literaturën e huaj.

Elitat shqiptare, jeta qytetare dhe marrëdhëniet me pushtetin

- Perceptimet mbi elitat shqiptare (politike, administrative, fetare, kulturore) dhe rolin e tyre në shoqërinë shqiptare.
- Qytetet shqiptare, jeta qytetare si hapësira pushteti, ndërveprimi social dhe moderniteti.
- Marrëdhëniet e elitave shqiptare me pushtetin osman, autoritetet lokale, shtetin dhe aktorët ndërkombëtarë.

Shqiptarët në dokumentacionin diplomatik të Fuqive të Mëdha

- Raporte konsullore, diplomatike, korrespondencë diplomatike dhe memorandumë.
- Shqiptarët si subjekt apo objekt i politikës ndërkombëtare.

Shqiptarët në historiografinë dhe publicistikën e huaj

- Qasje shkencore, ideologjike dhe propagandistike.
- Ndikimi i interesave politike në interpretimin historik.

Perceptime mbi shqiptarët gjatë Luftërave Ballkanike, Luftërave Botërore dhe Luftës së Ftohtë

- Raporte ushtarake, shtypi i huaj dhe dokumente politike.
- Imazhi i shqiptarëve në kontekste konflikti.

Identiteti kombëtar dhe fetar në sytë e autorëve të huaj

- Bashkëjetesa/toleranca fetare dhe interpretime rreth saj.
- Instrumentalizimi ideologjik i identitetit shqiptar.
- Kanuni në interpretimet e autorëve të huaj.

Shqiptarët në perceptimet e huaja gjatë periudhës së tranzicionit postkomunist dhe integriteteve euroatlantike

- Diskursi mbi shqiptarët pas rënies së regjimeve komuniste.
- Media ndërkombëtare, raporte institucionale dhe analiza akademike.
- Stereotype të reja dhe vazhdimësi me perceptimet historike.
- Ndikimi në ndërtimin e imazhit ndërkombëtar ndaj shqiptarëve.
- Rruga drejt BE: Diskursi mbi shqiptarët.

Shqiptarët e Kosovës në sytë e bashkësisë ndërkombëtare gjatë luftës për çlirim (1998-1999)

- Përfaqësimi në media, raporte ndërkombëtare dhe dokumente politike.
- Ndikimi i këtyre perceptimeve në ndërhyrjen ndërkombëtare.

Afatet për dorëzimin e abstrakteve dhe kumtesave të plota:

- Afati për dorëzimin e abstrakteve: 15 prill 2026, në adresën e emailit: instituti.historis@rks-gov.net
- Njoftimi për miratimin e kumtesave: 30 prill 2026.
- Afati për dorëzimin e punimeve të plota më 28 shtator 2026, me rastin e prezantimit të kumtesës në Konferencë.

Kumtesat dhe rezultatet e kërkimeve shkencore të pjesëmarrësve në Konferencë do të botohen në përmbledhje të veçantë.

Për informacion shtesë ju lutemi të na kontaktoni në adresën e emailit: instituti.historis@rks-gov.net

Me respekt, Teuta SHALA-PELI
Drejtoreshë e Institutit të Historisë “Ali Hadri”